



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. __, datë __. __. 2024

PËR KRIJIMIN E ZYRËS SË RIKUPERIMIT TË ASETVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, e Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është:

1. krijimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (në vijim, ZRA) si strukturë e posaçme qendrore në Policinë e Shtetit e cila është përgjegjëse për procesin e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente;
2. përcaktimi i organizimit, funksionimit, përgjegjësisë dhe bashkëpunimit të ZRA.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Pasuri”**: para ose instrumente të tjera pagese, mjete virtuale këmbimi, letra me vlerë, depozita, pasuri të tjera të çdo lloji, të prekshme ose të paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme, të drejta

të tjera pronësore, pretendime si dhe dokumente identifikimi dhe dokumente ligjore për pronësinë dhe pasuritë në formë të shkruar ose elektronike, formular ose instrument që vërteton të drejtën e pronësisë mbi pronën ose interesin ose pjesën takuese në këtë pronë.

2. **“Përfitime të tjera pasurore”**: pasuritë financiare, depozitat monetare dhe pronat e çdo lloji, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit, si dhe dokumentet ligjore apo instrumentet e çdo lloji, përfshirë ato elektronike ose digjitale, që provojnë pronësinë ose interesat në këto fonde dhe pasuri të tjera. Këtu përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, kreditë bankare, çeqet bankare ose të udhëtarëve, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, pagesat, letërkreditet dhe çfarëdo interesi, dividendi ose të ardhurat e tjera, si dhe vlerat që grumbullohen a gjenerohen nga fonde ose pasuri të tjera.

3. **“Ngrirje e përkohshme”**: ndalimi i çdo transaksioni, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve e të pasurive të tjera, për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Fondet dhe pasuritë e tjera, të ngrira përkohësisht mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës të bllokimit të përkohshëm.

4. **“Ngrirje e përkohshme”**: ndalim i përkohshëm i tranferimit, shkatërrimit, konvertimit, asgjësimit ose lëvizjes së pronës ose marrja përkohësisht në ruajtje dhe kontroll të pronës.

5. **“Sekuestrim”**: ndalimi i çdo transaksioni ose pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse. Fondet ose pasuritë e sekuestruara mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës së sekuestrimit.

6. **“Konfiskim”**: sipas kuptimit në nenin 36 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

7. **“Shkëmbim spontan informacioni”**: shkëmbim pa ndonjë kërkesë për këtë qëllim, i atij lloji informacioni dhe inteligjence apo edhe prove të cilat janë në dispozicion të autoriteteve shqiptare dhe që ata besojnë se mund të jenë të dobishme në hetimin e procedimeve penale ose mund të ndihmojnë në përfundimin e hetimeve penale në juridiksione të tjera, i cili mund të ndahet me autoritetet e huaja sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

8. **“Informacion dhe inteligjencë”**: çdo lloj informacioni ose të dhënash që mbahen nga autoritetet ligjzbatuese dhe çdo lloj informacioni ose të dhënash që mbahen nga autoritetet publike ose nga subjektet private dhe që janë në dispozicion të autoriteteve ligjzbatuese pa marrë masa shtrënguese.

Neni 3

Krijimi i ZRA

1. ZRA krijohet pranë Drejtorisë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, përfaqëson autoritetin kombëtar në nivel qendror për procesin e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sequestrimit ose konfiskimit, dhe gëzon pavarësi operationale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

2. ZRA financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme. Buxheti i ZRA është pjesë e programit buxhetor të emërtuar “Policia e Shtetit”.

Neni 4

Juridiksioni

ZRA e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për përmbushjen e qëllimit të saj, ZRA vepron edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në bazë të marrëveshjeve respektive.

Neni 5

Parimet bazë

Parimet bazë në bazë të të cilave udhëhiqet ZRA në veprimtarinë e saj, janë:

- a) profesionalizmi dhe integriteti;
- b) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- c) urgjenca dhe efikasiteti;
- d) besimi reciprok;
- e) konfidencialiteti;
- f) pavarësia operationale;
- g) paanshmëria politike;
- h) komunikimi i drejtpërdrejtë;
- i) komunikimi elektronik;
- j) ruajtja e informacionit të klasifikuar.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 6

Organizimi dhe funksionimi i ZRA

1. ZRA drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Struktura dhe organika e ZRA hartohen në përputhje me përgjegjësitë funksionale të parashikuara në këtë ligj dhe miratohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
3. Procedurat standarde të veprimit, miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të ZRA brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 7

Drejtori i Përgjithshëm i ZRA

1. Drejtori i Përgjithshëm i ZRA është autoriteti më i lartë ekzekutiv, administrativ e operacional i ZRA dhe përgjigjet drejtpërdrejtë para Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për realizimin e politikave, performancës dhe objektivave të përcaktuar.
2. Drejtuesi i ZRA përfaqëson Zyrën si pika qendrore kombëtare e kontaktit të Shqipërisë, me ZRA e huaja.
3. Drejtori i Përgjithshëm i ZRA emërohet për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi një herë.
4. Drejtori i ZRA:
 - a) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e ZRA;
 - b) menaxhon burimet njerëzore;
 - c) menaxhon dhe është përgjegjës për buxhetin;
 - ç) nxjerr akte administrative në lidhje me organizimin dhe funksionimin e ZRA në zbatim; të akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
 - d) përfaqëson ZRA në marrëdhënie me institucionet e tjera brenda vendit, si dhe në marrëdhëniet teknike dy ose shumëpalëshe me jashtë.
5. Drejtori i Përgjithshëm i ZRA duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
 - d) të ketë përvojë pune jo më pak se 10 vjet, ku 5 prej tyre në institucione ligjzbatuese;
 - e) të dallohet për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;

f) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
g) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.

6. Drejtori i Përgjithshëm i ZRA lirohet nga detyra, kur:

- a) i përfundon mandati;
- b) jep dorëheqjen;
- c) mbush moshën e pensionit.

7. Drejtori i Përgjithshëm i ZRA shkarkohet nga detyra, kur:

- a) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
- b) për shkelje të Kushtetutës apo për shkelje të rëndë të ligjit gjatë kryerjes së detyrës;
- c) për shkelje të rënda dhe shumë të rënda të disiplinës gjatë ushtrimit të funksioneve;
- ç) kur dalin fakte të reja që janë verifikuar dhe janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për emërim.

Neni 8

Komiteti Këshillimor

1. Pranë Drejtorit të Përgjithshëm të ZRA krijohet dhe funksionon Komiteti Këshillimor (në vijim, Komiteti).
2. Komiteti kryesohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Brendshme dhe ka në përbërje të tij, Drejtorin e Përgjithshëm të ZRA, përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Byrosë Kombëtare të Hetimit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Njësisë së Inteligjencës Financiare), Bankës së Shqipërisë.
3. Komiteti ka këto detyra:
 - a) këshillon ZRA në drejtim të mirëfunksionimit dhe koordinimit e bashkëpunimit me ZRA e huaja;
 - b) lehtëson bashkëpunimin mes ZRA dhe institucioneve të tjera;
 - c) sugjeron praktikat më të mira për t'u ndjekur;
 - d) jep mendim gjatë shqyrtimit, të politikave, dokumenteve strategjike dhe akteve ligjore e nënligjore që kanë lidhje me veprimtarinë e ZRA.
4. Komiteti mblidhet sa herë vlerësohet e nevojshme, me kërkesë të kryetarit të Komitetit ose Drejtorit të Përgjithshëm të ZRA.
5. Komiteti, miraton rregulla të hollësishme për funksionimin e tij.

KREU III

PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE DHE DETYRAT

Neni 9

Përgjegjësitë

1. ZRA është përgjegjëse për:
 - a) Gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen një ndalimi të përkohshëm për efekt të ngrirjes, sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente.
 - b) Shkëmbimin e informacionit, spontanisht ose sipas kërkesës, që lehtëson gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit.
 - c) Krijimin e mekanizmit për shkëmbimin e praktikave në lidhje me mënyrat për të përmirësuar efektivitetin e përpjekjeve për gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose janë të lidhura me to.
 - d) Mbledhjen e statistikave lidhur me gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to.
 - e) Bashkëpunimin me Rrjetet Ndërinstitucionale të Rikuperimit së Aseteve, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në to, si: CARIN, ARIN-AP, CFATF, ARIN-CA, ARINEA, ARINWA, ARINSA, RRAG.
 - f) Bashkëpunimin me Rrjete të Shkëmbimit të Informacionit, duke përfshirë Rrjetin Operacional kundër Pastrimit të Parave (AMON), Rrjetin Operacional Global të Autoriteteve të Ligjzbatuese Kundër Korrupsionit (UNODC Globe Network) dhe me rrjete e organizma të tjera që konsiderohen të përshtatshëm në funksion të kryerjes së veprimtarisë së ZRA.

Neni 10

Detyrat

1. ZRA ndërmerr aktivitete për gjetjen dhe identifikimin e të ardhurave, pasurisë ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, brenda vendit ose jashtë tij, ndaj një personi juridik ose personi fizik, shtetas shqiptar, shtetas i huaj apo pa shtetësi, si dhe për nevojat e procedurës së ngrirjes së përkohshme, konfiskimit pa përcaktuar përgjegjësinë penale e cila rregullohet sipas legjislationit përkatës në fuqi.
2. ZRA është e autorizuar të ketë akses dhe kërkon e merr informacion nga regjistri kombëtar i centralizuar i llogarive bankare për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të veprave penale.

3. ZRA kërkon dhe merr informacion financiar ose analiza financiare nga Njësia e Inteligjencës Financiare.
4. ZRA shkëmben informacion dhe praktika me ZRA të huaja për qëllim të parandalimit, zbulimit dhe hetimit nga organet kompetente ligjzbatuese ndaj veprave penale dhe autorëve të dyshuar të kryerjes së tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe për qëllim të hetimit penal ose financiar të ndërmarrë nga organet gjyqësore kombëtare dhe organet përkatëse kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar ose nga një autoritet gjyqësor i huaj.
5. ZRA shkëmben informacion dhe të dhëna dhe përvojat e praktikave me autoritete kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit.
6. ZRA administron, analizon, vlerëson raporte dhe informacione dhe kryen kërkime shkencore për çështje të lidhura me pasurinë që është produkt i veprës penale ose veprimtarisë kriminale, duke përdorur forma, metoda e mjete pune të analizës dhe vlerësimit të informacionit sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi për këtë qëllim.
7. ZRA mbledh rregullisht dhe mban statistika gjithëpërfshirëse në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.
8. Shkëmbimi i informacionit sipas këtij neni bëhet në bazë të kërkesës së marrë ose në përputhje me praktikave të shkëmbimit spontan të informacionit sipas përcaktimit në këtë ligj.

Neni 11

Shkëmbimi spontan i informacionit

1. ZRA dhe organet kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar shkëmbejnë informacion me njëra-tjetrën pa kërkesë të veçantë për këtë qëllim, pa kufizime apo në çdo kohë, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.
2. Informacioni shkëmbehet spontanisht në rastet kur një informacion i tillë mund të ndihmojë në gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurisë ose përfitimeve të tjera që lindin nga një vepër penale ose janë të lidhura me të, që mund të jetë objekt ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente.
3. ZRA transmeton në mënyrë spontane te autoritetet përkatëse kombëtare gjyqësore dhe ligjzbatuese dhe ZRA të huaja informacion në ndihmë të veprimtarisë së tyre.

Neni 12

Bashkëpunimi me rrjetet e tjera të rikuperimit të aseteve

1. Bashkëpunimi që rezulton nga pika e kontaktit e institucioneve të zbatimit të ligjit për Rrjetin Ndërinstitucional të Rikuperimit të Aseteve Camden (CARIN) dhe rrjetet e tjera ndërinsitucionale të rikuperimit të aseteve ndërmerret nëpërmjet ZRA.

2. Bashkëpunimi me CARIN dhe rrjetet e tjera ndërinsitucionale të rikuperimit të aseteve synon përmirësimin e njohurive të ndërsjella të metodave dhe teknikave të bashkëpunimit operacional në fushën e gjurmimit dhe identifikimit ndërkufitar të të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, aktivitet kriminal ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit;

Neni 13

Shkëmbimi i praktikave më të mira

ZRA shkëmben praktikat më të mira me ZRA të huaja për të përmirësuar efektivitetin e përpjekjeve për identifikimit të të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente.

Neni 14

Mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave personale

1. Të dhënat personale që gjenden në informacionin e shkëmbyer i nënshtrohen mbrojtjes në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

2. Organet kompetente janë të detyruara të respektojnë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave të shkëmbyera në përputhje me ligjin.

KREU IV

BASHKËPUNIMI ME ORGANET DHE INSTITUCIONET KOMBËTARE

Neni 15

Pikat e kontaktit sipas kërkesës nga ZRA

1. Organet kombëtare të sistemit të drejtësisë, organet e tjera kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar dhe autoritete e tjera kombëtare bashkëpunimi me të cilët i shërben përmbushjes së përgjegjesive të ZRA, me kërkesë të ZRA, caktojnë një pikë kontakti për ZRA.

2. Organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni janë të detyruara të informojnë menjëherë ZRA në rast ndryshimi të pikës së kontaktit.

Neni 16

Mënyra e komunikimit

1. ZRA komunikon në mënyrë elektronike me organet kombëtare të sistemit të drejtësisë, organet e tjera kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar dhe autoritetet e tjera kombëtare bashkëpunimi me të cilët i shërben përmbushjes së përgjegjesive të ZRA, duke paraqitur një kërkesë të skanuar e cila përmban të gjitha elementët e një kërkesë zyrtare ose një kërkesë të verifikuar përmes një certifikate digjitale të lëshuar në përputhje me ligjin.
2. Kur komunikimi elektronik nuk është i mundur, ZRA mund të komunikojë përmes komunikimit shkresor të mbrojtur.

Neni 17

Kërkesat drejtuar ZRA

1. Organet kombëtare të sistemit të drejtësisë, organet e tjera kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar dhe autoritete e tjera kombëtare bashkëpunimi me të cilët i shërben përmbushjes së përgjegjesive të ZRA, përmes pikave të kontaktit të caktuara, mundën që të depozitojnë elektronikisht kërkesë në adresë të ZRA.
2. Informacioni i kërkuar nga ZRA sigurohet brenda afateve të përcaktuara në kërkesë në përputhje me nenin 23 të ligjit.
3. Nëse ekziston një nga arsyet e parashikuara në nenin 23, pika 4, pika e kontaktit menjëherë informon ZRA.

Neni 18

Dorëzimi i kërkesave pranë Zyrës së ZRA-së

1. Organet kombëtare të drejtësisë dhe organet kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar përmes pikave të kontaktit mund të paraqesin në mënyrë elektronike kërkesat në Zyrën e ZRA-së për të marrë informacion mbi pasurinë në pronësi të personit juridik ose personit fizik ,shtetas shqiptar, person pa shtetësi ose të huaj.
2. Kërkesa, në varësi të rrethanave të rastit, duhet të përmbushë elementët e kërkuar për kërkesat e ardhura nga jashtë.
3. ZRA pa vonesë ia përcjell kërkesën ZRA-së së shtetit të huaj dhe pas marrjes së përgjigjes ia përcjell pa vonesë organit kërkues, përmes pikës së kontaktit.

Neni 19

Dorëzimi i njoftimeve në ZRA

1. Pika e kontaktit nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar njofton ZRA për kërkesën e dorëzuar për ndihmë juridike ndërkombëtare

e cila ka të bëjë me zbatimin e masave të të ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit, ku njëherësh i vë në dispozicion një kopje të kërkesës dorëzuar Ministrisë përgjegjëse.

2. Pika e kontaktit nga Ministria e Drejtësisë informon pa vonesë ZRA për kërkesën e pranuar nga jashtë për ndihmë juridike ndërkombëtare e cila ka të bëjë me ndalimin e përkohshëm të ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit.

3. Personi i kontaktit nga policia gjyqësore për rrjetet ndërinstitucionale të rikuperimit të aseteve, pa vonesë i paraqet ZRA kërkesën që e ka pranuar drejtpërdrejt nga organi kompetent i huaj.

4. Personi i kontaktit nga Gjykata dorëzon pa vonesë nga dita e hyrjes në fuqi një kopje të vendimit final përmes së cilit është përcaktuar masa e sekuestrimit ose konfiskimit.

5. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar infomon ZRA për rastet objekt të veprimtarisë së saj.

KREU V

BASHKËPUNIM ME ZRA TË HUAJA

Neni 20

Mënyra e komunikimit

1. Për çështjet e kompetencës së saj, ZRA-së komunikon drejtpërdrejt në mënyrë elektronike ose nëpërmjet transmetimit spontan të informacionit me ZRA në vende të tjera.

2. Komunikimi i ZRA me ZRA në vendet e tjera bëhet përmes kanaleve të komunikimit të sigurta elektronike.

3. Kur komunikimi elektronik nuk është i mundur, ZRA-së mund të komunikojë përmes komunikimit shkresor të mbrojtur.

Neni 21

Gjuhët në përdorim

Komunikimi ndërmjet ZRA-ve bëhet në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë ose në një gjuhë tjetër të dakordësuar nga palët e përfshira.

Neni 22

Kërkesat e ardhura nga jashtë

1. Bashkëpunimi ndërmjet ZRA-ve do të ndërmerret në përputhje me instrumentet evropiane në lidhje me thjeshtimin e shkëmbimit të informacionit dhe inteligjencës.

2. Elementët që duhet të përmbajë kërkesa miratohen me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të ZRA, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Krahas kërkesës, për veprën penale të cilës i referohet kërkesa, paraqitet edhe përmbajtja e dispozitave përkatëse të Kodit Penal të shtetit kërkuar.

Neni 23

Afatet për kërkesat

1. 7 ditë nga momenti i marrjes së kërkesës, për kërkesat që nuk janë urgjente;
2. 8 orë nga momenti i marrjes së kërkesës, për kërkesat urgjente të lidhura me kategori të tillë informacioni për të cilat ZRA ka akses të menjëhershëm dhe direkt.
3. 72 orë nga marrja e kërkesës nëse ZRA duhet të ndërmarrë hapa shtesë për të dhënë informacion përmes autoriteteve të tjera kombëtare.
4. Kur ekzistojnë arsye për të cilat kërkesa e marrë nuk mund të përmbushet brenda afatit të përcaktuar, ose kur kërkesa e pranuar nuk mund të përmbushet në asnjë rast, ZRA është e detyruar të njoftojë ZRA që ka paraqitur kërkesën, pa vonesë.

Neni 24

Refuzimi i një kërkesë të dërguar nga një ZRA e huaj

1. Kërkesa e dërguar nga një ZRA e huaj mund të refuzohet në rastet e mëposhtme:
 - a. kur mund të dëmtohen interesat thelbësore të sigurisë kombëtare të shtetit të cilit i kërkohet informacion;
 - b. kur mund të dëmtohet ecuria e një hetimi aktual, e një operacioni të inteligjencës në fushën penale ose siguria e individëve;
 - c. kur qëllimi për të cilën kërkohet informacioni është joproporcional ose jorelevant.
2. Për refuzimin e kërkesës njoftohet pa vonesë ZRA e huaj me arsyetimin përkatës.

KREU VI

BAZA E TË DHËNAVE ELEKTRONIKE

Neni 25

Baza e të dhënave dhe infomacioni statistikor

1. ZRA mbledh, ruan dhe përpunon statistika gjithëpërfshirëse duke përfshirë statistika të cilat ndihmojnë ZRA në përmbushjen e përgjegjësiave dhe detyrave të saj, të siguruara nga organet gjyqësore kombëtare dhe organet kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar.
2. ZRA mirëmban dhe përditëson një bazë të dhënash elektronike e cila integron informacion mbi:
 - a) kërkesat e marra dhe të dërguara nga dhe për zyrat e huaja të ZRA;
 - b) kërkesat e marra dhe të dërguara në kuadër të ndërveprimit të ZRA brenda vendit;
 - c) marrjen dhe dërgimin e raporteve mbi praktikën e ndjekur;
 - d) marrjen dhe dërgimin e informacionit të shkëmbyer në rrugë spontane;
 - d) marrjen dhe dërgimin e informacionit mbi masat e ngrirjes së përkohshme;
 - e) marrjen dhe dërgimin e kërkesave për bashkëpunim ndërkombëtar në lidhje me masën e e sekuestrimit ose të konfiskimit.
3. Baza e të dhënave elektronike përmban informacione statistikore relevante për aktivitetet e ZRA.
4. Llojet e informacionit të kërkuar statistikor pjesë përbërëse të databazës sipas pikës 2 të këtij neni, miratohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm, sipas sugjerimeve të Komitetit Këshillimor.

5. ZRA ka ose krijon akses të drejtpërdrejtë në të gjitha databazat në të cilat ka akses Policia e Shtetit.

KREU VII

Neni 26

DISPOZITA TRANZITORE

1. Drejtori i Përgjithshëm i ZRA emërohet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Deri në plotësimin e strukturës së ZRA, drejtori i Përgjithshëm do të mbështetet në detyrat e tij nga punonjës të Policisë së Shtetit.

Neni 27

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Ministri i Brendshëm për nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë e zbatim të këtij ligji brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA